



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health


Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2024/2025 (JAVA 19-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2020/2021 - 2024/2025

Sipas grafikorit 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2024/2025 karakterizohet me numër më të lartë të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2023/2024 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të, 2024/2025 (Graf.1).

Grafikoni.1



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2024/2025 DHE PRAGU EPIDEMIK


Nga fillimi i sezonës, 30 shtator 2024 deri më 11 maj 2025 (java e 19-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 108,308 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 11,536 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 139 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 19-të (05.05.2025-11.05.2025) janë raportuar 1,518 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 280 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 1 rast SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 21 raste ILI, 1 rast ARI dhe 1 rast SARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 19-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasur me javën e kaluar shënon një plato me një rënie minimale prej 4.64% (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Gjilanit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Prishtinës dhe Kamenicës. (Graf.3).


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç (Graph.4). Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (5,077 raste) pastaj grup-mosha 15-64 vjeç (3,520 raste), 5-14 vjeç (1,777 raste) dhe grup-mosha 65+ vjeç (1,162 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2024/2025 deri me 15 maj 2025, janë testuar gjithsej 5,570 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 2,778 (49.87%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 2,792 (50.12%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 18 raste (0.64%). Nga 2,792 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 787 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 28.18 %). Sipas tipit: me Influcencë A (378 raste apo 13.53%) dhe Influcencë B (409 raste apo 14.64%). Nga 787 rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B, sipas komunave: Mitrovicë (242 raste), Prishtinë (233 raste), Fushë Kosovë (47 raste), Podujevë (26 raste), Vushtrri (26 raste), Lipjan (26 raste), Drenas (24 raste), Malishevë (22 raste), Pejë (21 raste), Ferizaj (20 raste), Obiliq (16 raste), Skenderaj (15 raste), Suharekë (11 raste), Prizren (10 raste), Gjilan (9 raste), Gjakovë (6 raste), Shtime (6 raste), Rahovec (6 raste), Klinë (6 raste), Viti (5 raste), Hani i Elezit (3 raste), Istog (2 raste), Dragashi (2 raste) dhe me nga një rast komuna e Graçanicës, Novobërdës dhe Deçanit, kurse sipas grup-moshës: 0-4 vjeç (305 raste), 5-14 vjeç (220 raste), 15-29 vjeç (96 raste), 30-44 vjeç (56 raste), 45-60 vjeç (59 raste) dhe 60+ (51 raste). Gjatë javës së nëntëmbëdhjetë (05.05.2025-11.05.2025), në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK janë testuar 31 mostra si të dyshimta në SARS-CoV-2. Kurse nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 44 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 207 mostra me RSV, 211 mostra me Human Rhinovirus, 139 mostra me Human Adenovirus, 59 mostra Metapneumovirus dhe 16 mostra me Parainfluenza Virus.


Nga 207 rastet pozitive në RSV (7.41%): 181 (87.43%) prej tyre i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç, 13 raste i takojnë grup-moshës 5-14 vjeç, 15-34 vjeç (4 raste), 35-50 vjeç (1 rast), 51-64 vjeç (2 raste) dhe 65+ vjeç (6 raste), kurse sipas komunave: Prishtinë (81 raste), Fushë Kosovë (19 raste), Podujevë (16 raste), Vushtrri (13 raste), Drenas (10 raste), Ferizaj (7 raste), Malishevë (6 raste), Obiliq (6 raste), Lipjan (5 raste), Mitrovicë (5 raste), Skenderaj (5 raste), Shtime (5 raste), Gjilan (4 raste), Klinë (4 raste), Kaçanik (4 raste), Pejë (4 raste), Suharekë (3 raste), Prizren (3 raste), Gjakovë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Rahovec, Deçan, Viti, Hani i Elezit dhe Kamenicë.

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me Influcencë A të pasubtipizuar janë 343 raste (43%), me subtipin AH3 janë 30 raste (4%), me subtipin AH1N1 janë 5 raste (1%), Influcencë B të pasubtipizur janë 400 raste (51%) dhe Influcencë B Victoria 9 raste (1 %).

Grafikoni.6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor dhe sanitar të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2024/2025, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori 2024 deri me 24 prill 2025 janë administruar 68,628 doza. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 45,950 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 21,137 me sëmundje kronike, 1,502 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatëzëna dhe 36 fëmijë (0-5 vjeç).

HOSPITALIZIMET

Sipas raportit javor të rasteve të hospitalizuara me regjistër nga Klinika Infektive, Klinika e Pediatriës dhe spitalet rajonale janë raportuar 20 raste me ARI dhe 1 rast me SARI.

Nga Klinika Infektive përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse deri më 15 maj 2025, janë raportuar 5 raste të vdekjes me Influencë A dhe 1 rast i vdekjes nga COVID-19. Të gjitha rastet janë të gjinisë mashkullore, i përkasin grup-moshës mbi 60 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË**INFLUENCA SEZONALE JAVA 19/2025 NË EVROPË**

Gjatë javës së 19-të të vitit 2025, aktiviteti i viruseve respiratore në vendet e Bashkimit Europian dhe Zonës Ekonomike Europiane (BE/ZEE) është kthyer në nivele të ulëta, sipas të dhënave të raportuara nga kujdesi parësor dhe sistemet e mbikëqyrjes për sindromën e infeksioneve të rënda respiratore akute (SARI). Në pjesën më të madhe të vendeve, intensiteti i gripit ka rënë ndjeshëm, me normat e pozitivitetit të testimeve nën 10%, ndërsa nëntipet më të shpeshta të identifikuar janë viruset e gripit A(H3) dhe B. Megjithëse aktiviteti i RSV-së (virusit respirator sincicial) ka rënë nga kulmi i arritur në javën e 52-të të vitit 2024, ai vazhdon të qëndrojë në nivele të larta për shkak të variacionit kohor mes vendeve të ndryshme. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka mbetur në nivele të ulëta, pa pasur shpërthime të dukshme në këtë sezon.

Sezona e gripit 2024/2025 është karakterizuar nga një sezon intensiv gripi dhe një epidemi e njëkohshme e RSV-së. Aktiviteti i përgjithshëm i gripit ka kulmuar në javën e 6-të të vitit 2025, me një dominim fillestar të nëntipit A, pasuar më pas nga bashkëqarkullimi ose dominimi i virusit B në disa vende.

Nga aspekti epidemiologjik, ndikimi më i madh i gripit në kujdesin shëndetësorë terciar është vërejtur te të rriturit mbi 45 vjeç, ndërsa për RSV është raportuar ndikim i lartë te fëmijët nën moshën 5 vjeç. Megjithëse në shumicën e vendeve aktiviteti i viruseve është në rënie, në vendet ku ende qarkullojnë këto viruse ekziston rreziku për ngarkesë shtesë në sistemet shëndetësore, veçanërisht aty ku kapacitetet janë të kufizuara.

Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) vijon mbikëqyrjen javore përmes sistemit të përmbledhjes ERVISS dhe ka publikuar rekomandime për masa të shëndetit publik për të zbutur ndikimin e viruseve gjatë dimrit 2024/2025. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë zbatimin rigoroz të masave të kontrollit të infeksioneve në ambientet shëndetësore dhe vaksinimin e grupeve në rrezik, që mbetet mjeti më efektiv për të parandaluar format e rënda të sëmundjeve respiratore.

Vlerësimet e përkohshme për efektivitetin e vaksinës së gripit për sezonin 2024/2025 tregojnë se vakcina ka parandaluar nga një e treta deri në më shumë se tre të katërtat e infeksioneve të gripit që kanë kërkuar kujdes mjekësor. Efektiviteti ka ndryshuar sipas grupmoshave dhe vendndodhjeve të studimit. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i hershëm i antiviralëve për gripin në rastet e përshtatshme dhe vazhdimi i praktikave parandaluese si larja e duarve, distancimi fizik, shmangia e grumbullimeve dhe përdorimi i maskave në ambientet shëndetësore.

Burimi: <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/communicable-disease-threats-report-week-18-2025.pdf>